



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:282789

Datë: 07.03.2024

Numri i dokumentit: 05424701

C.nr.1285/21

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike kontestimore të paditësve A.H, B.H dhe SH.P, të cilët sipas autorizimit i përfaqësojnë Av. F.G dhe Av. K.F me seli të zyrës në Prishtinë, rruga .. kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, me objekt kontesti kompensimin i shpenzimeve të udhëtimit, jashtë seance me datë 07.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësve A.H dhe SH.P, për kompensimin e 70% të shpenzimeve të udhëtimit, DETYROHET e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim që:

- Paditëses A.H në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit prej 70% të çmimit të biletës prej 0.70 cent, për periudhën nga data 17.12.2018 e deri me 30.04.2021 ($357 \times 0.70 = 249.90$), t'ia paguajë paditëses shumën totale prej 249.90 euro.
- Paditëses SH.P në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit prej 70% të çmimit të biletës prej 0.70 cent, për periudhën nga data 17.12.2018 e deri me 27.09.2021 ($526 \times 2.10 = 1,104.60$), t'ia paguajë paditëses shumën totale prej 1,104.60, euro me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga dita e parashtrimit të padisë (16.12.2021), e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

II. REFUZOHET pjesërisht si e pabazuar kërkesëpapia e paditëses A.H për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit në relacionin D.- S., në shumën prej 249.90 euro, si dhe kërkesëpapia e paditëses SH.P, për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit në relacionin V.- S.. në shumën prej 368.20 euro.

III. REFUZOHET në tërësi kërkesëpapia e paditësit B.H për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit prej 70% të çmimit të biletës, në shumën prej 420.00 euro.

A r s y e t i m

Paditësit A.H, B.H dhe SH.P, të cilët sipas autorizimit i përfaqësojnë Av. F.G dhe Av. K.F me seli të zyrës në Prishtinë, pranë kësaj gjykate kanë paraqitur padi me datë 16.12.2021, me të cilën kanë kërkuar që të obligohet e paditura, që t'ua kompensoj shpenzimet e udhëtimit si dhe t'i kompensojë në emër të kualifikimit arsimor- licencimit, me kamatë ligjore prej 8%, nga paraqitja e padisë si dhe i kanë kërkuar shpenzimet e procedurës. Ndërsa, me precizimin e datës 13.02.2024 kanë kërkuar që të kompensohen në emër të shpenzimeve të udhëtimit për periudhën nga data 17.12.2018 e deri më 17.12.2021, dhe atë për paditësen A.H për 357 ditë pune shumën prej 499.80 euro, për paditësin B.H për 600 ditë pune, shumën prej 420.00 euro, si dhe për paditësen SH.P për 526 ditë pune, shumën prej 1,472.80 euro. Po ashtu i kanë kërkuar shpenzimet e procedurës.

Të autorizuarit e palëve ndërgjyqëse kanë arritur Marrëveshjen e Ndërmjetësimit me numër Nd.nr.899/23 të datës 13.11.2023, të cilën gjykata e ka aprovuar me Aktvendimin e datës 20.11.2023. Në marrëveshjen e arritur palët janë dakorduar që e paditura t'ua kompensojë të gjithë paditëseve në emër të kualifikimit- licencimit, shumat e përcaktuara më gjerësisht si në marrëveshje. Andaj, pjesë e kërkesëpadisë ka mbetur vetëm kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit për të gjithë paditësit. Po ashtu, të autorizuarit e palëve janë pajtuar edhe për pagesën e shpenzimeve të procedurës, të specifikuar si në marrëveshjen e lartcekur.

Gjykata me aktvendimin C.nr.1285/21 të datës 21.09.2023, e ka obliguar të paditurën që të përgjigjet në padi, të cilin aktvendim e ka pranuar me datë 22.09.2023, ndërsa përgjigjen në padi e ka paraqitur me datë 28.09.2023.

Në përgjigjen në padi e paditura ndër të tjera ka deklaruar se padia dhe kërkesëpapia e paditësve është parashkruar pasi që Kontrata Kolektive e Arsimit është nënshkruar më 18.04.2017, ndërsa

paditësit e kanë paraqitur padinë në gjykatë me datë 16.12.2021, ndërsa Kontrata Kolektive e Arsimit është me efekt veprimi deri më 18.04.2020, dhe se e njëjta nuk ka efekt për asnjë kërkesë e cila lind pas kësaj date. E paditura gjithashtu ka theksuar se të njëjtës i mungon legjitimacioni pasiv për të qenë palë në këtë procedurë kontestimore, ngase e paditura nuk ka qenë pjesëmarrëse në marrëdhëniet detyimore dhe nuk ka marrë obligime për përmbushjen e këtyre detyrimeve që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit. Gjithashtu gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë si të pa bazuar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 dhe 399 të LPK-së, për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, pasi që në mes palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit merititor.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura në padi dhe në përgjigjen në padi, gjykata ka gjetur se nuk ishte kontestuese se paditësit kanë themeluar marrëdhënie pune me të paditurën, fakt ky që konstatohet edhe nga kontratat e punës dhe atë për paditësen A.H kontrata numër 41/18, e datës 23.06.2020, për paditësin B.H kontrata numër 121/26, e datës 26.09.2018, si dhe për paditësen SH.P kontrata numër 123/26, e datës 28.09.2018.

Kontestuese nuk ishte po ashtu rrethana se e paditura Komuna e Vushtrrisë, nuk ka bërë kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit.

Kontestuese ishte parashkrimi i kërkesës së paditësve.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se *“kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, andaj duke ju referuar dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), përkatësisht nenit 245, paragrafit 1, me të cilin përcaktohet se *“kreditore në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitorit ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, e lidhur me dispozitën e nenit 35 par.5 të Kontratës Kolektive të Arsimit të vitit 2017 ku parashihet se *”Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70%*

të biletave të trafikut urban”, erdhi në përfundim se kërkesa e paditëseve A.H dhe SH.P është pjesërisht e bazuar.

Këtë gjykata e vërtetoi edhe nga provat e ofruara nga paditëset dhe atë për paditësen A.H, nga vërtetimi i datës 06.05.2021, i lëshuar nga SHFMU “M.”, në Vushtrri, vërtetohet se paditësja ka punuar në këtë shkollë për 357 ditë pune, në periudhën nga data 17.12.2018 e deri më 30.04.2021. Po ashtu, nga vërtetimi i lëshuar nga SH.P.K “N.”, Vushtrri, vërtetohet se paditësja ka udhëtuar në relacionin D.- M., ku çmimi i biletës kthyese është 1.00 euro, andaj edhe ia njohu paditëses shumën prej 249.90 euro, për 357 ditë pune sipas vërtetimit të lartcekur, duke përllogaritur një ditë pune në vlerë prej 0.70 cent ($357 \times 0.70 = 249.90$).

Nga vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “Rr.” në fshatin .., Komuna e Vushtrrisë, me nr. të protokollit 132, vërtetohet se paditësja SH.P ka punuar në këtë shkollë për 526 ditë pune, në periudhën nga data 17.12.2018 e deri më 27.09.2021. Po ashtu, nga vërtetimi i lëshuar me datë 07.11.2023 nga B.I “B.”, Vushtrri, vërtetohet se paditësja ka udhëtuar në relacionin V.- S., ku çmimi i biletës kthyese është 3.00 euro, andaj edhe ia njohu paditëses shumën prej 1,104.60 euro, për 526 ditë pune sipas vërtetimit të lartcekur, duke përllogaritur një ditë pune në vlerë prej 0.70 cent ($526 \times 2.10 = 1,104.60$).

Kundërshtimin e të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditëseve, gjykata e vlerësoi si të pa bazuar pasi që në Ligjin e Punës, përkatësisht në nenin 87 të tij është përcaktuar se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, ndërsa paditësit kërkesën e tyre e kanë parashtruar për periudhën nga data 17.12.2018 e deri me datë 17.12.2021, që përfshinë periudhën kur ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 18.04.2017 dhe ajo e datës 22.01.2021, ndërsa padinë e kanë paraqitur në gjykatë më 16.12.2021.

Ndërsa, sa i përket pretendimit të të paditurës se i mungon legjitimacioni pasiv për të qenë palë në këtë procedurë kontestimore, gjykata gjeti se edhe ky pretendim është i pa bazuar për arsye se konform nenit 35 par.5 të Kontratës Kolektive të Arsimit, punëdhënësi ka për obligim të sigurojë kompensim për shpenzimet e udhëtimit, e që në këtë rast punëdhënësi për paditësen nuk ka qenë ndonjë organ apo institucion tjetër shtetëror, por ka qenë këtu e paditura Komuna e Vushtrrisë- Drejtoria për Arsim. Andaj, gjykata në këtë rast vlerëson se e paditura e ka legjitimacionin pasiv në këtë çështje.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që paditëset A.H dhe SH.P nuk kanë ofruar dëshmi të mjaftueshme për ta bërë të besueshme bazueshmërinë e kërkesës së tyre. Kjo për faktin se paditësja A.H ia ka bashkangjitur padisë një vërtetim të lëshuar nga N.T “L..”, Vushtrri, në të cilin thuhet se ka qenë udhëtare e rregullt në relacionin D.. – S.., mirëpo paditësja nuk i ka ofruar gjykatës asnjë dëshmi tjetër në të cilën do të bazoheshin shpenzimet e udhëtimit në këtë relacion, përkatësisht nuk ka ofruar dëshmi- vërtetim se ka punuar në ndonjë shkollë në fshatin .., e po ashtu në kontratën e punës së saj tek fusha institucioni arsimor, figuron vetëm SHFMU në M.., e nuk figuron asnjë shkollë tjetër.

Gjithashtu, paditësja SH.P ia ka bashkangjitur padisë një vërtetim të lëshuar nga “Q..”, Mitrovicë, në të cilin thuhet se ka qenë udhëtare e rregullt në relacionin V.. S.., mirëpo paditësja nuk i ka ofruar gjykatës asnjë dëshmi tjetër në të cilën do të bazoheshin shpenzimet e udhëtimit në këtë relacion, përkatësisht nuk ka ofruar dëshmi- vërtetim se ka punuar në ndonjë shkollë në fshatin .., e po ashtu në kontratën e punës së saj tek fusha institucioni arsimor, figuron vetëm SHFMU “Rr..”, *fshati*, e nuk figuron asnjë shkollë tjetër.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ngase paditësi B.H nuk i ka sjellë gjykatës vërtetimin e lëshuar nga ndonjë kompani të udhëtimit, me të cilën do të vërtetohej relacioni i udhëtimit si dhe çmimi i biletës, edhe pse në kuptim të nenit 102 të LPK-së, gjykata me aktvendimin e datës 29.01.2024, ua ka kthyer në plotësim padinë paditësve, por që paditësi B.H me parashtrësë i ka dorëzuar gjykatës vetëm vërtetimin e lëshuar nga shkolla për ditët e pranisë në punë, ndërsa si dëshmi për biletë ka bashkangjitur vetëm një kupon fiskal, nga i cili nuk mund të vërtetohet relacioni i udhëtimit. Andaj, gjykata kërkesëpadinë e paditësit e refuzoi në tërësi si të pa bazuar.

Nga të gjitha të lartcekurat, bazuar në nenin 399 par.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia.”*, si dhe par.2 ku thuhet se *“Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*, si dhe në nenin 7 par.1 të LPK-së, ku përcaktohet se *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*, gjykata vlerësoi se paditësit nuk kanë

ofruar prova të mjaftueshme, andaj vendosi si në pikën II dhe III të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata, përveç kërkesës kryesore paditëseve A.H dhe SH.P ua njohu edhe të drejtën në kamatë në lartësi prej 8% në vit, duke llogaritur nga paraqitja e padisë (16.12.2021), e deri në pagesën definitive, duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 par.2 të LMD-së dhe Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, për Kamatën, me numër 265/2020, i datës 01.12.2020.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës, edhe pse paditësit në padi i kanë kërkuar, siç u theksua edhe më lartë, palët janë dakorduar për shpenzimet në procedurë të ndërmjetësimit, andaj nuk ishin objekt i shqyrtimit të gjykatës.

Bazuar në të lartcekurat, e në kuptim të nenit 143, 398 dhe 399 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.1285/21, me datë 07.03.2024

Gj y q t a r i

Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.